



## Me Art për Drejtësi

Youth Initiative for Human Rights në Kosovë fton shkollën/universitetin tuaj të aplikojë në thirrjen “Me art për drejtësi”. Nxënësit/studentët tuaj ftohen të dërgojnë punime mbi atë se si e shohin ata sistemin e drejtësisë në Kosovë, duke përfshirë këtu dhe sfidat e tij.

Pra, si e mendojnë nxënësit drejtësinë në Kosovë? A mundet me e luftu korrupsioni, nepotizmi, diskriminimi dhe shkeljet e të drejtave të njeriut në Kosovë përmes artit? A mendoni se mund të zhvillohet mendimi kritik i të rinjëve përmes krijimeve artistike?

Krijimi artistik mund të jetë:

- Foto, video, pikturë, karikaturë, poster apo instalacion artistik.
- Video nuk mund të jetë më e gjatë se një (1) minutë.
- Të gjitha krijimet duhet të kenë për bazë opinionin dhe pikëpamjet personale të aplikantit/es mbi sistemin e drejtësisë në Kosovë.

Gara do të përfshijë shkollat e mesme të larta dhe universitetet e rajonit të Prishtinës, Ferizajit, Pejës dhe Gjakovës. Shkolla apo universiteti mund të dorëzojë tri punime gjithsej, punimet shtesë mund të dorëzohen direkt nga nxënësit/studentët përmes email-ave të tyre personal.

Bashkë me punimin, shkolla/universiteti duhet të dërgojë edhe informatat personale të nxënësit/studentit që ka realizuar punimin (emri dhe mbiemri, qyteti/komuna, shkolla apo universiteti, data e lindjes, e-maili dhe telefoni) dhe një shpjegim/koncept për punimin e dorëzuar (deri në 200 fjalë).

Afati i fundit për aplikim është **20 maj 2020**.

Pasi gara të mbyllet, të gjitha punimet do të vlerësohen nga një komitet vlerësues profesional, i përbërë nga dy profesorë/e të Fakultetit të Arteve dhe një përfaqësues/e të YIHR KS.

Fituesit/et e garës do të shpërblehen me libra apo paisje shkollore në vlerë prej:

- **Vendi i I-rë** - 300 Euro
- **Vendi i II-të** - 200 Euro
- **Vendi i III-të** - 100 Euro

Punimet më të mira po ashtu do të ekspozohen në aktivitetet e YIHR KS dhe në hapësirat e gjykatave themelore të Prishtinës, Ferizajit, Pejës dhe Gjakovës ku do të qëndrojnë brenda hapësirave të gjykatave me qëllim të informimit të qytetarëve për çasjen në drejtësi në mënyrë kreative.

Për çdo pyetje apo paqartësi, na kontaktoni në [apply@yih.org](mailto:apply@yih.org)

Ju inkurajojmë ta ndani me nxënësit/studentët tuaj këtë thirrje dhe të shfrytëzoni mundësinë për aplikim.